



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.724/14 prot.

Datë 28.04.2025

V E N D I M

Nr. 570/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28.04.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.455/2025, datë 09.04.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur - punë” me nr. REF-26563-10-28-2024, me objekt: “Rikonstruksioni i rrugës “Pusi i Mezinit”, me fond limit 49,744,339.25 (dyzetë e nëntë million e shtatëqind e dyzetë e katër mijë e treqind e tridhjetë e nëntë.25) lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 13.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

Ankimues:

Operatori ekonomik “K.M.K” SHPK me NIPT L78223801E dhe adresë Ballsh-Mallakaster, Bulevardi Rrapo Hekali, Shkalla 1, Kati 1, Z.Kadastrale 1090, Nr.Pasurie 7/9810.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Vlorë me adresë Sheshi “4 Heronjtë”, Rruga “Osman Haxhiu”

Subjekt i interesuar:

Operatori ekonomik “Sterkaj” SHPK me NIPT J68310708M dhe adresë Tiranë, Njësia Bashkiake Nr. 5, Blv. "Bajram Curri", mbrapa pallateve Agimi, Pallati 7/1B, Kati 2

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.

285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 09.04.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.455/2025, ku vendosi:

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “K.M.K” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur - punë” me nr. REF-26563-10-28-2024, me objekt: “Rikonstruksioni i rrugës “Pusi i Mezinis”, me fond limit 49,744,339.25 (dyzetë e nëntë million e shtatëqind e dyzetë e katër mijë e treqind e tridhjetë e nëntë.25) lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 13.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.
2. Autoriteti kontraktor të zbatojë vendimin e KSHA-së të ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike me datë 01.04.2025 përmes shkresës nr.4871 prot., datë 28.03.2025 protokolluar me tonën me nr. 724/2 prot., datë 01.04.2025.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të njoftojë KPP mbi zbatimin e vendimit të KSHA duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “K.M.K” SHPK.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr.6201/8 prot., datë 22.04.2025, protokolluar me tonën nr. 724/11 prot., datë 28.04.2025, autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 455/2025 datë 09.04.2025 duke u shprehur se: “Me marrjen e këtij Vendimi, autoriteti kontraktor menjëherë ka ndjekur hapat e mëposhtëm:

-Urdhër heqje pezullimi, me Nr. 5787 prot, datë 14.04.2025;

-Procesverbal për hyrjen në Sistemin Prokurimit Elektronik me Nr.16606/23 prot., datë 14.04.2025;

-Procesverbal për rivlerësim të procedurës së prokurimit në Sistemin e Prokurimit Elektronik me Nr.16306/24 prot, datë 14.04.2025;

-Kërkesën për dorëzim të dokumentacionit të operatorit ekonomik “K.M.K” shpk me nr. 16306/25 prot, datë 14.04.2025.”

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr.6201/8 prot., datë 22.04.2025, protokolluar me tonën nr. 724/11 prot., datë 28.04.2025, autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 455/2025 datë 09.04.2025 duke u shprehur se: *“Me marrjen e këtij Vendimi, autoriteti kontraktor menjëherë ka ndjekur hapat e mëposhtëm:*

-Urdhër heqje pezullimi, me Nr. 5787 prot, datë 14.04.2025;

-Procesverbal për hyrjen në Sistemin Prokurimit Elektronik me Nr.16606/23 prot., datë 14.04.2025;

-Procesverbal për rivlerësim të procedurës së prokurimit në Sistemin e Prokurimit Elektronik me Nr.16306/24 prot, datë 14.04.2025;

-Kërkesën për dorëzim të dokumentacionit të operatorit ekonomik “K.M.K” shpk me nr. 16306/25 prot, datë 14.04.2025.”

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik duke kualifikuar operatorin ekonomik “K.M.K” SHPK në përputhje me vendimin e KSHA-së së autoritetit kontraktor për të cilin sipas parashikimeve të nenit 115 të LPP-së, KPP me vendimin nr.455/2025, datë 09.04.2025 ka mbyllur çështjen.

II.3. Sa më sipër, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor, ka zbatuar vendimin e KSHA-së së tij për të cilin sipas parashikimeve të nenit 115 të LPP-së, KPP me vendimin nr.455/2025, datë 09.04.2025 ka mbyllur çështjen për procedurën e prokurimit “E hapur - punë” me nr. REF-26563-10-28-2024, me objekt: “Rikonstruksioni i rrugës “Pusi i Mezinit”, me fond limit 49,744,339.25 (dyzetë e nëntë million e shtatëqind e dyzetë e katër mijë e treqind e tridhjetë e nëntë.25) lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 13.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur - punë” me nr. REF-26563-10-28-2024, me objekt: “Rikonstruksioni

i rrugës “Pusi i Mezinit”, me fond limit 49,744,339.25 (dyzetë e nëntë million e shtatëqind e dyzetë e katër mijë e treqind e tridhjetë e nëntë.25) lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 13.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaïd Myzyri

